



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY
ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e 22-të e Legjislacionit të VI-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 31.10.2019 (e enjte), në sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------|-------------------------------|
| 1. Qaush Balaj, LDK; | 15. Muhamet Ukaj, AAK; |
| 2. Zenel Shatri, LDK; | 16. Eliot Kukiqi, AAK; |
| 3. Besa Ferati, LDK; | 17. Ardita Idrizaj, AAK; |
| 4. Naim Behlulaj, LDK; | 18. Jehonë Haxhijaj, AAK; |
| 5. Njomza Demaj, LDK; | 19. Arben Kabashi, PDK; |
| 6. Haki Podrimaj, LDK; | 20. Ajshe Metaj, PDK; |
| 7. Selajdin Bytyqi, LDK; | 21. Mirushe Sadikaj, PDK; |
| 8. Valbona Demaj, LDK; | 22. Labinot Alijaj, PDK; |
| 9. Edona Lubeniqi, LDK; | 23. Lavdije Bujupaj, VV; |
| 10. Riza Dreshaj, LDK; | 24. Arif Elshani, IQ; |
| 11. Ruzhdi Metaj, LDK; | 25. Radoš Repanović, SL; |
| 12. Naim Imeraj, AAK; | 26. Radenko Belošević, RB dhe |
| 13. Misin Berisha, AAK; | 27. Slaviša Maliković, SM. |
| 14. Nexhmedin Balaj, AAK; | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në të ishin të pranishëm edhe Kryetari z.Haki Rugova, Nënkryetari Agim Ademaj, drejtorë të drejtorive të komunës, përfaqësues të OSBE-së, KFOR-it, përfaqësues të shoqërisë civile, mediave, disa qytetarë etj, (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverballi dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe në CD-të e xhirimit, të cilat gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit, z.Qaush Balaj. Kryesuesi përshëndeti të pranishmit hapi punimet për mbledhjen e 22-të të Legjislacionit të VI-të. Për këtë mbledhje propozon këtë rend dite.

Rendi i ditës

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i Raportit financiar për tre mujorin e tretë (korrik-shtatorë) të vitit fiskal 2019;
4. Shpallja në diskutim publik e projekt-Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2020;
5. Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit vjetor të Kuvendit Komunal për vitin 2020;
6. Rishqyrtimi i Rregullores për Transparencë Komunale;
7. Rishqyrtimi i Vendimit për Planin Zhvillimor Komunal 2019-2027 dhe
8. Pyetje dhe përgjigje nga anëtarët e Kuvendit Komunal.

Kryesuesi, atëherë kush është që të miratohet ky rendit i ditës për këtë mbledhje?

Kuvendi në mënyrë unanime, miratoi rendin e ditës për këtë mbledhje, pa ndryshime.

Në procedurën e votimit nuk mori pjesë: Zenel Shatri dhe Haki Podrimaj.

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi, njoftoi se për këtë mbledhje nuk mungon askush. Gjithsej në mbledhje janë të pranishëm 27 (njëzetë e shtatë) këshilltarë.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi, vazhdon me pikën e dytë të rendit të ditës, miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A ka dikush diçka lidhur me këtë procesverbal?

Labinot Alijaj, unë kërkoj që në procesverbalin e mbledhjes kaluar të shënohet edhe pjesa që Kryetari me ka premtuar për projektin që kam propozuar, aty ku thotë së është vendim i imi, që ky projekt do të realizohet me bashkëfinancim.

Kuvendi në mënyrë unanime miratoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar, me vërejtje.

Obligohet shërbimi për punë të kuvendit që të bëjë përmirësimin në procesverbalin e mbledhjes kaluar.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Zenel Shatri, Haki Podrimaj, Radoš Repanović dhe Radenko Belošević.

Shqyrtimi i pikës 3

Kryesuesi- vazhdon me pikën e tretë të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit financiar për tre mujorin e tretë (korrik-shtatorë) të vitit fiskal 2019

Osman Sadikaj, Zyrtar Kryesor Financiar, përshëndeti të pranishmit dhe prezantoi Raportin financiar për tre mujorin e tretë (korrik-shtatorë) të vitit fiskal 2019.

Naim Imeraj, përshëndeti të gjithë të pranishmit, falënderon për fjalën Kryesuesin dhe ZKF-në për shkoqitjen e këtij raporti dhe përmbledhjen për tre tremujorët e parë për vitin 2019. Kisha dëshirë që të shpreh besimin tim, që ky raport ka vëllim analitik të mjaftueshëm që mund të bëhet çfarëdo krahasimi për faktin se janë trekatër dokumente në Excel, me nëntëmbëdhjetë faqe pune dhe njëzetë e pesë mijë rreshta. Kjo na jep hapësirë se si anëtar të kuvendit të jemi në dijeni se çfarë ka ndodhur me të hyrat dhe me shpenzimet në këtë periudhë. Po filloj me të hyrat vetanake, janë disa çështje që lidhen me funksionimin e administratës komunale respektivisht me ne si qytetarë të komunës Istogut. Mendoj se analitika që është bërë është praktikë e mirë sepse ka pasur raste tjera që nuk është bërë pra faleminderit që na ke dhënë këta tre mujor si analitikë. Keni durim pak me minutazhin që do ta kem në dispozicion. ZKF e dha pjesën që ka qenë munguese në këtë raport: të hyrat nga gjobat, çofshin ato policore, gjyqësorë si dhe nga Agjencioni i Pyjeve. Unë më shumë do të ndalem të të hyrat vetanake, kodi 21. Duke marrur parasysh planin për 2019 është plus-minus, është 100 mijë euro më shumë se në vitin 2018 dhe të hyrat janë plus-minus 100 mijë euro ma shumë për periudhën raportuese 2018, atëherë del është një balancë krahasuar me vitin e kaluar. Mendoj se realizimi i drejtë siç u raportu 74%, të kodi 21 len me besu se sikur edhe vitin e kaluar që është arritur të përmbushja e planit e të hyrave vetanake, do të arrihet edhe këtë vit. Në dispozicion është dhënë analitika sipas kodeve ekonomike dhe programeve buxhetore por unë më shumë janë fokusuar në analitiken sipas kodeve ekonomike së është më e specifikuar edhe është më shumë ë lidhur prej burimeve konkrete të të hyrave. Duke qenë se analitika e kodeve ekonomike jep një laramani të suksesshmerisë, çoftë në realizimin e planit çoftë në përqindje, do të thotë në aspektin relativ apo në aspektin relativ si valutë euro atëherë i kam dhënë vetes një liri që ta bëj një klasifikim siç vijon. Një kategori e këtyre kodeve ekonomike paraqet përqindje të dalluara të përmbushjes së planit. Këtu janë lejet e ndërtimit me 140%, lejet mjedisore me 110%, të cilat realisht janë si përcjellje e lejeve të ndërtimit. Mirëpo gjithmonë kam pasur vërejtje në proceset planifikuese se planifikimi të lejet e ndërtimit është i ulët, për sa shohim çka po ndodh në aspektin e ndërtimit planifikimi është i ulët. Ka edhe "anomali" të llojet, përmbushje e licencave të afarizmit, nuk e dijë së çfarë licenca lëshojmë ne dhe cilat janë ato? Ndër të dalluara është edhe regjistrimi i automjeteve 86%, që realisht nëse e krahasojmë më vitin e kaluar e jep një konstatim se nuk është duke rënë standardi, po regjistrojmë vetura më shumë. Kategori tjetër është

kategoria e përqindjeve mesatarisht të arriturave, kur po them përqindje të arritur është fjala në raport me planin. Edhe këtu është një raportim që tatimi në pronë është rritë por në anën tjetër ka mbetë tatimi i mbledhur nga borxhet e raportuara dhe kur mblidhen ato bashkë dhe bëhen si plan, del se është 71%. Do të thotë tatimi në pronë nuk është 89% por është 71% edhe si zakonisht është shtylla e të hyrave e mbajtjes së të hyrave vetanake e buxhetit. Edhe në planifikim i bije që është 40%, tatimi në pronë, tatimi në tokë. Përqindjet tjera është kategoria që unë e kam vlerësuar si nën planifikim këto janë: certifikatat administrative për kundër faktit nga kategoritë të tjera është realizuar 200%, mirëpo nuk e dije çka? Nëse i bëjmë bashkë kategoritë tjera është një realizim i planit prej 48%, e siç jeni në dijeni gjithmonë kam thënë nuk kemi planifikim të mirëfilltë tek administrata. Kemi një mbi planifikim, i cili në vazhdimësi është përcjellë, vit pas viti. Po i them me kohë që kur hymë në fazën planifikuese mos me ndodhë prapë. Unë nuk mund ta hekë përgjegjësinë prej veti por përgjegjësinë e ka shumica kështu që kur bëhet planifikim duke e marrë parasysh që i gjuhet shumica tatimit në pronë e mandej me kalkulu me këto tjerat është jo shumë praktike, nuk po e vazhdoj këtë fjali. Me duhet fatkeqësisht me përfunduar më një përqindje totalisht të deshtume, që janë dy kategori: ndërrimi i destinimit të tokës, që janë 500 euro krahasuar me 20 mijë euro të planifikuara e që bënë me ditë, kjo punë ka mbetë në vullnetin e atyre që dojnë më ardh më thënë dua me ndërru. Se nuk është duke u bërë ndonjë veprim efikas për parandalimin e keqtrajtimit respektivisht të legalimit të tokës jo ndërtimore, respektivisht që ajo mund të jetë toke bujqësore. Është e vjetër mirëpo 2% në realizim është më të vërtetë e deshtume edhe së fundi por jo më qellim që me ja lanë kësaj analize atë përshtypjen e keqe, se e thash në fillim 73%, të arriturave është një pritje që do të realizohet. Do të thotë është e mirë që realizohet sepse janë pare që i kemi këtu tonat, që nuk mundet me than askush që shkuan suficit apo nuk shkuan suficit. Është problematika e shfrytëzimit të pronës publike çoftë ajo si pronë publike apo si objekte publike. Ne kemi 3 mijë e ca euro të mbledhura në planifikimin prej 53 mijë eurove. Tash përqindja nuk ka nevojë me thanë që është 6, e që më të vërtetë është shqetësuese, e këtu shtrohet pyetja a ka argumentim për këtë? Kush është kompetent me argumentua çka po ndodhë në vazhdimësi me pronën publike, që ne këtu si kuvend në aspektin e tjetërsimit eventual jemi kompetent. Por normal nuk e hjeku atë peshën e kompetencës e kryetarit të komunës me legjislacionin e ri që edhe me bazat e dhënies në shfrytëzim që i kemi pas të pronat publike. Veç diçka më intereson, a ka në mesin e tyre që kanë obligime, a i din se këto janë obligime? A janë këto 53 mijë apo janë obligime të fakturueshme me faktura qysh janë fakturat e tatimit në pronë edhe a ka në mesin e tyre që kanë obligime dhe në tjetrën anë kanë qasje në fondet publike? Tenderojnë kanë kompani marrin tendera prej komunës që për mua është e pa pranueshme. Derisa dikush nuk i shlyen obligimet e veta në raport me neve qysh mundet me kërkua me perfitu, me pas qasje në fonde publike kur nuk i shlyen obligimet e veta në raport me fondet publike? Ose kemi planifikim të keq, që don argumentim. Do të përpiqna që të jem pak më i shkurt në pjesën e shpenzimeve, fatmirësisht është shtuar edhe një kodë tek burimet e financimit është kodë i financimit huamarrje, janë shpenzuar 1 milion. Nëpër Facebook-a kemi rre

gjoks të gjithë nga pak për merita. Ne si kuvend që e kemi miratu, ekzekutivi që ka planifiku, qeveria që ja ka dhënë përkrahjen e ka pa të mundshëm që me u ekzekutu. Edhe individ normal kapak me rre gjyks se e ka hijen. I dëshiroj edhe vetes si Uçali me pronë edhe Naim Behlulit kolegut dhe kushëririt, që ky projekt me u krye, sa ma shumë me hekë ju atë dert të kalislerave të ujit. Të bie hise se je pak më i ri edhe të bije hise me u angazhua me i dhanë vormak kësaj pune se unë po i shohë edhe 1 milion të tjera këtu që janë ta alokuara për sivjet. Inshalla edhe ato shpenzohen edhe me pa definitivisht që është ka ndodhë diçka. Në rregull kam parë gypa në facebook po shpresojë që po hyjnë me ndonjë bager por mirë, shumë jam i kënaqur. Në këtë analizë që do të vazhdoj me i cek këto nuk do ta marr parasysh këtë huamarrje, është diçka e jashtëzakonshme fakti që prej 5 milionëve i kemi hargju veç 1 milion, e ulë atë përqindjen e asaj qa kemi muajt na me pa. Kështu që në vazhdimësi besoj që duhet me u trajtu si një diçka, fundi i fundit janë 5 milion e na hiç pagat, 5 milion krejt i kem në të gjitha programet ekonomike, 5 milion e gjysmë për afërsisht në të gjitha programet ekonomike: mallra dhe shërbime, shpenzime komunali, subvencione, pasuri jo financiare respektivisht projekteve kapitale. Ajo çka po dua me thanë është që krahasuar me tre mujorshin e njëjtë të vitit 2018 kemi përqindje të rritur të shfrytëzimit do të thotë ka qenë një efikasitet i shpenzimit më i lartë për 3% . Derisa vitin e kaluar pa hua ka qenë dikund 49%, shfrytëzimi në 2018 këtë vit është dikund 53%, fjala është me gjithë paga. Pagat vin i futim në gjep ose në konto i nënshkruajmë por nuk janë kategori të cilat mujm me analizu në aspektin e kontributit ekzekutiv. Këto që jam duke i thanë janë informata te cilat ekzekutivi i din, që pjesa dërmuese e kolegëve anëtarëve të kuvendit komunal i din ose së paku e kanë pas mundësinë me u informu. Por nuk është keq që të informohen edhe qytetarët me qëllimin më të mirë. Se ka edhe problematika ka suksese, po i bijë edhe më shkurt. Nëse i heqim pagat edhe pa e përfshi huan te programet ekonomike, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere dhe pasuri financiare kemi një shpenzim prej 31,3%. Që është më e lartë se sa në periudhën e njëjtë të vitit 2018. Dallimet janë vetëm subvencionet e kalojnë 60%-shin, këto të tjerat janë 54, mallra dhe shërbime janë 49,6% , është pak çështje e asaj edhe herën e kaluar po më kujtohet që në këtë periudhë e kam thënë. A thu a kemi me mujt me bërë ma shumë si ekzekutiv? Ok projektet kapitale janë që zgjasin edhe nuk munden mu kthye për 30 ditë, mundet 60 ditë, 90 ditë varësisht, po munden me qenë edhe shumë vjeçare. Po këto mallra dhe shërbime çka po i leni në tre mujorshin e fundit, thjesht është një prej pyetjeve a ka arsye që mallrat dhe shërbimet me mbete në 3 mujorshin e fundit? Janë të zotuar edhe 14%, tjera po këto 37%, që janë ta pa zotuar, a keni me mujt për një gjysmë periudhe me i krye? E di se është bërë ajo gjithmonë por me cilin kualitet edhe në llogari? Nëse janë prej burimeve të hyrave vetanake nëse vitin e kaluar i kemi pasur 560 mijë të transferuara nuk ka dert i transferojmë këtë vit 770 mijë, po shpresojë që nuk ka me ndodhë, dakord.

Atëherë problematika është te ky 21,2%, të pasurive jo financiare është më shumë se sa 18,8 të vitit të kaluar, është më shume se 18,8, janë të zotuar 59% por janë edhe 20 %, që e kanë rrezikun e pamundësisë së mbylljes së procedurave edhe me na shku suficit. Mos harroni se kemi dërguar suficit vitin e kaluar. Për këtë jam edhe

duke u mundu që këto informacione me kanë të dobishme, në vazhdimësi gjatë gjithë kohës duke e analizuar pa paga. Kisha dashtë me dit mirë këto që si kemi mbledhë këto 21-shi të hyra vetanake, që nuk kemi mund me i mbledh e që janë ardhur me vonesë, e raportohen me vonesë, e që shkojnë në buxhet me vonesë. Por këto që po thotë 2018, realisht janë 2016/17/18 po edhe tash në 2019, 38% edhe 36%, paret në gjep janë prej 1 janari. Nuk po them po, qe prej shkurti a marsi paret në gjep e këtu është një lojë, më vjen keq. Paratë në gjep e të pa shfrytëzuara, e di problematiken e dy viteve të fundit. Nuk kemi bërë rishikim të buxhetit në vitin e kaluar e as në këtë vit. Por duhet me u mësu me planifiku mirëfilltë, e jo me planifiku me përmbush appetite çoftë menaxheriale brenda administratës, çoftë të presionit të grupacioneve të interesit jashtë në administratën komunale. E me bërë projekte të cilat janë me shuma të perealizueshme kur po vjen puna po duhet me i bërë dy prej një për me mund me perfundu një. Nëse kem rishikim të buxhetit nëse nuk kem rishikim të buxhetit aq sa lejon ligji me bërë ridestinim. Edhe çka po bëhet të hyrat vetanake po i gjuajmë dashtë e pa dashtë në vitin vijues. Ndërsa ato që nuk transferohen që janë ardhur prej buxhetit qendror shkojnë suficit, që është dëm. Çofshin edhe 150mijë çofshin edhe 200mijë çofshin edhe aq sa janë.

Edhe një problematik tjetër pa hidhërim të programet buxhetore nuk kemi shfrytëzim proporcional sipas buxheteve të mjeteve: shëndetësia, shërbimet publike, arsimit dhe administrata i kanë shpenzuar në këtë periudhë 1 milion prej 2 milion e 480 mijë të planifikuar. Që i bien 40%, ndërsa: zhvillimi ekonomik, bujqësia, planifikimi urban e hapësinor dhe kultura i kanë shfrytëzu 500mijë, gjysmën e atyre për përafërsisht të njëjtin planifikim. Mirë kishte me qenë dikush në këto 10 sekondat, po bëjë pyetje me ma shpjegu, çka është kjo divergjencë? Pse disa drejtori apo programe buxhetore kanë mund e disa nuk kanë mund ? A është problemi të prokurimi apo ku është problemi? Kryesues pa më ardhur hiq keq, që i mora gjithë këta minuta, faleminderit për fjalën.

Kryetari, ju përshëndes, nuk do t'i komentoj këto. Më shumë është si një lloj analize që e ka bërë Naim Imeraj. Të dëgjova me vëmendje dhe mund të them se janë konstatime dhe vërejtje me vend. Me të hyrat qëndrojmë më mirë por me shpenzime kapitale si gjithmonë janë pak mbrapa për arsye të llojllojshme. Sa i përket komunalive, aty munden më u bërë ki plotësisht të drejtë ndoshta është shenjë e angazhimit jo të duhur të stafit komunal. Rreth projektit të madh të mbivades unë nuk dua të rrahi gjoks, unë e di që kanë folur dhe është shfrytëzuar ajo në fushatë. Unë ju kam përmbajt gjithmonë në mënyre konstante fjalëve të mija dhe nuk e kam përdorur këtë projekt për propaganda zgjedhore as në fushatë lokale, as në tjera. Ky projekt ka filluar që katër-pesë vite. Tash së kush është meritator nuk do të diskutojmë më shumë. Meritat kryesore të jeni të sigurt se i ka kryetari i komunës dhe stafi, prej angazhimit të tij fillestar. Nuk ka qenë kjo asamble hiq dhe me duket është e treta. Mirë si do që të jetë jemi duke shkuar mirë, janë afatet kohore dhe projekti do të realizohet deri në 2021, me sa di deri në muajin mars. Jam i bindur dhe kemi garancione të forta, që ai do të përfundojë brenda vitit të ardhshëm. Kjo është me rëndësi dhe do të përmbillet një projekt shumë i rëndësishëm. Gypat kanë ardhur

dhe do të fillojë ndërtimi sipas projekteve që janë bërë. Keni parasysh se materiali do të vonojë pak të vijë për shkak se janë dyqind kamionë, që do të sjellin gypat. Puna është nisur mirë dhe jam i sigurt se do të përfundoj mirë. Sa për informatë, më çështje financiare janë duke u marrë dy zyrtarë komunal: Gani Sylaj dhe Genc Ademaj. Janë më detyre zyrtare, si certifikues. Ndërsa Genc Ademaj është i kyçur që nga ditët e para dhe është një ndër meritorët për realizimin e këtij projekti.

Dua të them edhe një gjë se harrova të them, se të çështja e shpenzimeve kapitale po kemi shumë telashe, me ankesa të llojllojshme, me veprime të mbrapshta. Mendoj se edhe këtë vit do të kalojmë 75% dhe kanë mbetur edhe disa ditë është dita e fundit e shpalljes së tenderëve dhe e zotimit. Kemi projekte dy vjeçare, tre vjeçare edhe disa projekte me të mëdha.

Ajshe Metaj, falënderon për fjalën dhe përshëndeti të pranishmit. Unë dua të ndalem të një projekt: "Kubëzimi i trotuarit Vrellë-Stupe -Kamenicë", ne e dimë së është kryer ajo pjesa por kisha kërku që "Kamnicë" të hiqet. Pasi projekti është ndërpre. Kisha dashtë të ndalem edhe të dy projekte të tjera që është dashtë të realizohen këtë vit: "Shtatorja Ibrahim Rugova" mandej "Ngritja e lapidarit të Sheshi i Gjakut" unë dua të dijë së kur do të realizohen?

Kryetari, vendimi është marrë aty për tri këto projekte dhe kemi filluar nga të hyrat vetanake. Do të startojmë dhe sot do të del shpallja publike për Shtatoren e Ibrahim Rugoves, mendoj se do të fillojë këtë vit. Por janë projekte që do të zgjasin. Janë edhe projekti të Sheshi i Gjakut dhe për Fadil Feratin. Nuk janë fillu së te sheshi do të bëhet edhe një rrugë. Vendimi është marr dhe do të realizohen gjithsesi.

Arben Kabashi, përshëndeti të pranishmit, meqenëse kolegu e beri një analizë në detale e analizuar shumë mirë e që unë e përgëzoj. Është njëri që i kupton gjerat në thelb dhe në detale. Nuk kam çka të shtoj përveç do vërejtje që i përmendi kolegu Naim. U dha vërejtja të shpenzimet komunalit dhe çdo here po kemi rritje të këto shpenzime. Thjesht nga të hyrat planifikimi është shumë i dobët, nganjëherë e tejkalon masën që e përmendi kolegu. Jemi në tre mujorshin e fundit dhe ka projekt që është i planifikuar për këtë vit dhe përfundon këtë vit e ende nuk kanë filluar. Nuk po hy në detale që t'i përmendi projektet. Kam pyetje për ZKF-në, se a përfundojnë këto apo mundet të ju zgjatet afati?

Osman Sadikaj, po përgjigjem për pyetjen e Naim Imeraj. Ka shqetësimin pse nuk janë realizuar të hyrat nga disa planifikime me përqindje të ulët konkretisht nga pronat? E dini mirë se kemi problem të tokat bujqësore që ne kemi realizu të hyra por që nuk realizojmë për shkak të procedurës së identifikimit, regjistrimit edhe përgatitjes për dhënie me tender. Ne nuk marrim qera nga tokat bujqësore. Pse janë të rritura lejet e ndërtimit dhe mjedisit? Lejet e mjedisit janë rritë për shkak se ajo ka lindur von si obligim. Tatimi në pronë ke shqetësim realizimi është i realizuar edhe në bazë të borxheve dhe në bazë të këtij viti. Sa i përket tatimit në pronë ka filluar në 2019 për tokat por jo për tokat bujqësore, ka filluar si pilot projekt për tokat që janë

me objekte dhe vitin e ardhshëm pritet të faturohet edhe për tokat bujqësore. Të gjitha janë para në gjep realisht jo vetëm të kodi 22. Të gjitha ato shuma që janë të kolona alokim është para në thesarin e komunës. Burimet e financimit përveç grantit qeveritar me kod 10, shkojnë në suficit çka nuk shpenzohen. Data e fundit e shpenzimit është 24 dhjetor 2019.

Naim Imeraj, tre tremujor të këtij viti janë shpenzuar 34 mijë 539 euro përmbarime, vendimeve sipas gjykatave, është shumë ma shumë në fund të vitit 2018. Cila është arsyeja?

Osman Sadikaj, është çështja që përmbaruesi nuk na pyet. Nuk do të thotë që edhe deri në fund të vitit nuk do këtë të tjera. Edhe pyetja të shpenzimi i buxhetit të disa drejtoritë, ne kemi tri drejtoritë që kanë buxhetin rreth 70%.

Shqyrtimi i pikës 4

Kryesuesi, vazhdon me pikën e katërt të rendit të ditës: Shpallja në diskutim publik e projekt-Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2020, lidhur me këtë pikë fjalën ia kalon. **Hysni Maxharri**, Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

Hysni Maxharri, përshëndeti të pranishmit, kemi ardhur të kjo pikë. Kjo nuk ka ndryshime, propozimet i keni. Kjo do të shpallet në diskutim publik para qytetarëve, nëse ka dikush ndonjë pyetje apo propozim?

Slaviša Maliković, përshëndetje për te pranishmit, dua vetëm te theksoj se fshati Serbobran ndodhet në komunën e Istogut, por qe nuk është paraqitur në asnjë vend, është ky gabim teknik apo jo, do te doja te kem një përgjigje?

Kuvendi me 18 vota për, pa vota kundër dhe pa abstenime shpalli në diskutim publik projekt-Rregulloren për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2020. Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Nexhmedin Balaj, Riza Dreshaj, Agron Avdijaj, Valbona Demaj, Haki Podrimaj, Radoš Repanović dhe Radenko Belošević.

Shqyrtimi i pikës 5

Kryesuesi, vazhdon me pikën e pestë: Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit vjetor të Kuvendit Komunal për vitin 2020. E kemi pasur një grup punues që ka punuar vitin e kaluar. Është koha që të formojmë këtë grup punues, unë po ju rikujtoj se vitin e kaluar e kemi pasur Haki Podrimaj, Nexhmedin Balaj, Ajshe Metaj, Lavdije Bujupaj dhe Slaviša Maliković .Fjalën ja kaloi Mirushe Sadikajt, pastaj Zenel Shatrit e më radhë.

Mirushe Sadikaj propozoi **Arben Kabashi** nga PDK.

Zenel Shatri propozoi **Haki Podrimaj**, LDK.

Naim Imeraj propozoi **Nexhmedin Balaj**, AAK.

Lavdije Bujupaj vazhdoj të jem nga radhët e VV.

Slaviša Maliković nga radhët e SM.

Kuvendi me votim 22 për, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi Formimin i Grupit punues për hartimin e Planit vjetor të Kuvendit Komunal për vitin 2020.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Ardita Idrizaj, Arif Elshani, Agron Avdijaj, Radoš Repanović dhe Radenko Belošević.

Shqyrtimi i pikës 6

Kryesuesi, vazhdon me pikën e gjashtë të rendit të ditës: Rishqyrtimi i Rregullores për Transparencë Komunale. Jeni në dijeni se mbledhjen e fundit kemi aprovu këtë rregullore, bazuar në procedura të gjitha aktet e kuvendit dërgohen për shqyrtim të ligjshmërisë. Lidhur me këtë rregullore është kthyer një sugjerim që kërkohet që të përfshihet një ligj, i cili ka ndryshu me vonë. Nëse ka nevojë drejtoresha mund ta në sqaroj më gjerësisht. Nëse nuk dëshiron fjalën askush kush është për që kjo rregullore të miratohet?

Kuvendi me votim 22 për, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi Rregulloren për Transparencë Komunale.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Ardita Idrizaj, Arif Elshani, Agron Avdijaj, Radoš Repanović dhe Radenko Belošević.

Shqyrtimi i pikës 7

Kryesuesi, vazhdon pikën e shtatë të rendit të ditës: Rishqyrtimi i Vendimit për Planin Zhvillimor Komunal 2019-2027. Lidhur me këtë pikë kemi një vërejtje lidhur me vendimin që ka shkuar për shqyrtim të ligjshmërisë. Kemi vërejtje në formulimin e Vendimit për miratimin e Planit Zhvillimor. Fjalën ja kaloi Zenel Shatrit.

Zenel Shatri, përshëndetje për të gjithë, këto dy vërejtje që janë bërë unë mendoj se i atribuohen shërbimit juridik. Kështu që një vërejtje publike dhe të kenë kujdes që mos të kthehen përsëri, pajtohem që të miratohet.

Arben Kabashi, kam një pyetje për Drejtorinë e Urbanizmit për këtë plan. A mund të ndryshojë ky plan sepse tani është ndërruar edhe qeveria ndërrohet edhe trasea e rrugës që vjen prej Mitrovice, që është e planifikuar? A mund të ndërroje ndonjë nen i këtij plani?

Nënkryetari, nuk ma mer mendja që duhet të ndryshojë plani. Vendimet që i mer qeveria për planet zhvillimore që i ka, çka duhet të ndërhyhet në planet rregullative urbanistike të komunave.

Naim Imeraj, duke ja lëshuar sytë njërit versionit edhe tjetrit version, problemi është substancial nuk është teknik. Derisa me vendimin e herës së kaluar më shumë në fjali të shkurta janë thur "lavde" kush është meritör që ka ndodhë kjo, në vendimin që është kthyer në rishqyrtim, janë përcaktimet ligjore. Kështu që ju bashkëngjitem vërejtjes së doktorit mos me i shkru "lavde" po në bazë të detyrave që i keni të përshkruara. Nuk po flas për ata që jemi këtu por për ata që në fund të muajit nënshkruhen e ju vjen në konto një shumë për atë punë që e kanë bërë, lë të jetë në përputhje me përshkrimin e vendeve të punës.

Kuvendi me votim 22 për, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi Vendimin për Planin Zhvillimor Komunal 2019-2027.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Ardita Idrizaj, Arif Elshani, Agron Avdijaj, Radoš Repanović dhe Radenko Belošević.

Shqyrtimi i pikës 8

Kryesuesi, po vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës: pyetje nga anëtarët e kuvendit komunal. Pyetje me shkrim nuk kemi. Fjalën e ka kërku Ajshe Metaj, Labinot Alijaj dhe Arben Kabashi.

Ajshe Metaj, falenderon për fjalën, nuk është prezent drejtori i arsimit sepse për atë kam pyetje. Unë e kam ngrit si çështje edhe herën e kaluar dhe tani jam e shtyer edhe nga kolegët e mijë por nuk e di që se a mund të më jap përgjigje? Unë po e ngris për të katërtën here çështjen e pagave jubilarë për çështjen e arsimit dhe askush nuk po me jap përgjigje. Ka punëtor që 42 vite ka punuar dhe të shkoj në pension pa e marr asnjë pagë jubilarë e kjo çështje është ngrit që sa kohë.

Labinot Alijaj, përshëndeti të pranishmit, unë deshta një pyetje për Drejtorin e Drejtorisë për Shërbime publike z.Enver Rugovën. A është i informuar që ndërmarrja publike "Hidrorini" po i dërgon te përmbaruesit familjet që janë raste sociale? Do të thotë është e vërtetë që ata duhet me i bërë pagesat por ish dasht në një mënyrë më të lehtë, jo me i dergu te përmbaruesi. Edhe çka me ju blloku, me ja blloku socialin kam raste që mu kanë ankuar e për ata dashta me pyet a ka informacion a është i informuar?

Nënkryetari, nuk ka të bëjë me Hidrodrinin këtu, as me menaxherin, e as stafin këtu. Krejt është përmes regjionit, drejtorja qëndrore që është në Pejë, normal që i ka konsumatorit e vet edhe është duke i dërgu te përmbaruesi pa pasur nevojë me u konsultu me njësin këtu. Sepse ata janë më të mëdhenjë po dihet, domethanë është duke shkuar kjo procedurë si kompetencë e "Hidrodrinit" regjional. Kjo është përgjegjja, këta këtu vetëm sa i malltreti se nuk është duke i pyetur askush asgjë.

Zenel Shatri, edhe unë i kam do shqetësime sepse janë ardhë disa njerëz, që më të vërtet nuk kanë, e që i kanë ardhë me përmbartues? A ka mundësi me nivele më të larta me bisedu, në atë mënyrë që me bërë një konsultim me organizatën "Hidrodrini" këtu. Degën e kësaj oragnizate të madhe, në mënyrë që me marrë një vendim prej tyre dhe me ndiku. Se njëfarë mënyre jo se po i shkojn atij të cilit më të vërtetë se meriton edhe nuk ka, ndërsa nuk i shkojn ati që ka. Le të shikojn kryetari, nënkryetari që ka ndonjë mundësi me ndiku në nivele më të larta.

Nënkryetari, doktorr deri tash njesit edhe Istogut edhe njesit tjera të regjionit e kanë pas një mundësi me i dhënë emrat. Normalisht që nuk janë shku te rastet sociale, rastet e varfura mirëpo tash një kompetencë e tillë e kanë marr ata direkt. Atje edhe po e zbatojnë, mundë të bëhen biseda mundë të kontaktohen por te shohim sa ka rezultat, këto janë ta pavarura si ndërrmarrje por mund të bisedojmë.

Naim Imeraj, i shqetësum që është prek ajo kategori por unë besoj që egziston një mekanizëm I komunikimit në mes të borxhëlisë dhe atij që ja kërkon borxhin. Që është mirëkuptimi që faktizohet me një proces të riprogramimit të borxhit, ju kisha rekomandu kush do që ka borxh me ju drejtu atyre që ju ka borxh. Me pranë borxhin edhe me hy në riprogramim që mos me shku në procesin përmbartimit egziston kjo edhe te subjektet juridike, besojë edhe të individët. Njerëzit munden me qenë të pa informuar unë po e sfhrytëzojë këtë foltore që eventualisht me marr këtë informat e me shku se e çbllokujnë këtë. Hynë me riprogramim për me çblloku konton këto janë informacionet që unë i kam prej asaj sa kam qasje në këtë problematik, faleminderit.

Nënkryetari, Naim normal që ka mundësi të riprogramimit por kemi mbërri në fazen kur riprogramimi edhe bisedat duhet me u bërë me përmbartuesin. Jo më me tjetër kënd. Këtu tash është problemi duhet me u bërë bisedat me përmbartuesin, klienti duhet të shkoj tek përmbartuesi me të me bërë kontratën , marrveshjen edhe përmbartuesi e merr përqindjen e vetë në çdo pagesë që e bënë.

Lavdiqe Bujupaj, përshëndeti të pranishmit, pyetja ime ka të bëjë me kompleksin që gjendet në qendër të Istogut. Ish pronë e Korenikut më vonë e menxhuar nga AKP-ja nga ky kuvend patem kërkuar, që ajo pjesë të mbetet interes i komunës. Si kshilltare e kuvendit komunal nuk jam në dijeni çfarë ka ndodhë më vonë, cila është përgjegjëja e AKP-së. Dhe çuditërisht atje po e shohë që po punohet që dy ditë, a mundet dikush nga ekzekutivi me na tregu së pari cila ka qenë përgjegjëja e AKP-së lidhur me atë pjesë? a po vazhdon të jetë pronë e AKP-së apo ka kaluar në kompetenca të komunës?

Jehonë Haxhijaj, përshëndeti të pranishmit, unë propozojë që të punohet Rregullorja për Barazi Gjinore, shumë komuna e kanë këtë rregullore dhe do të kishte me qenë mirë edhe komuna jonë me pas. Pasi që dihet barazia gjinore është shtylla e vetme drejt zhvillimit ekonomik dhe social edhe na hap rrugë drejt suksesit.

Kryesuesi, duke ju falënderuar për pjesëmarrje në këtë takim dhe kontributin e dhënë i shpalli të mbyllura punimet për këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi me punë në ora, 12:30.

**Procesmbajtëse,
Arlinda Kurtaj**



**Kryesues,
Z. Qaush Balaj**

Qaush Balaj